



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 589/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07/09/2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Ura e Cerencit - Steblevë, Qafë Bualli-Krastë, Burrel-Komesi; Ura e Matit-Lis; K/Ulëz-Ulëz; Trebisht-Dogane 75.92 km”, me nr. REF-73550-06-05-2018, me fond limit 89,446,948 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.07.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Selami” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k.  
Adresa: Lagjia “Pjetër Budi”, Burrel, Dibër.

**Autoriteti kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.  
Adresa: Lagjia “3 Heronjt”, Rr.”At Zef Valentini”, Shkodër.

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.2. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 06.06.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Ura e Cerenecit - Steblevë, Qafë Bualli-Krastë, Burrel-Komesi; Ura e Matit-Lis; K/Ulëz-Ulëz; Trebisht-Dogane 75.92 km*”, me nr. REF-73550-06-05-2018, me fond limit 89,446,948 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.07.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2 Në datën 04.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 25.07.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- |   |                                       |
|---|---------------------------------------|
| 1. "Gjoka Konstruksion" shpk,                   | 70,905,466 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 2. "Selami" shpk,                               | 76,013,844 lekë pa tvsh Kualifikuar;  |
| 3. "Alko-Impex General Construction" shpk       | 81,115,092 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 4. "Vllaznia Ndërtim I.S" shpk,                 | 87,891,960 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 5. "2AF Albania Group"&"Alb Leaa International" | 81,115,092 lekë pa tvsh Kualifikuar   |

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

*"Nuk keni plotsuar Preventivin sipas kerkesave te dst. Ne Dst keni tre preventive me dy çmime te ndryshme ju ne oferten tuaj keni paraqitur nje preventiv per te gjthe gjatesine e kontrates me nje lloj çmimi,Pra oferta juaj eshte e pa vlefshme"*

II.4.Në datën 01.08.2018 operatori ekonomik ankimues "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kërkon verifikimin e plotë të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik të kualifikuar, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 330 Prot. datë 08.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij.

II.6.Në datën 16.08.2018 operatori ekonomik ankimues "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Selami" sh.p.k., duke argumentuar si më poshtë vijon:

*"[...]Bazuar ne ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014 PËR PROKURIMIN PUBLIK, KREU VII: PROCEDURAT E RISHIKIMIT ADMINISTRATIV, Neni 63/1,2,3 "Te drejtat e personit te interesuar", konstaton se vleresimi i bere nga KVO i Autoritetit Kontraktor per objektin e siperpermendur, nuk eshte ne perputhje me me ligjin e prokurimit dhe kriteret e vecanta ne Dokumentat Sandarte te Tenderit te vendosura per kete procedure. "Vllaznia Ndertim I.S" kerkon vleresimin si te rregullt te ofertes se kompanise sone, pasi Oferta pavaresisht formatimit jo sipas formes se kerkuar eshte brenda vleres se fondit limit. Gjithashtu eshte dhene oferte per punimet rutine si dhe dimerore dhe se zerat e punimeve te preventivit per te cilin nuk eshte dhene oferte jane pothuaj se te gjitha zero, rrjedhimisht vlere e punimeve qe nuk eshte dhene oferte nuk e kalon masen 2% siç e percakton ligji masen e gabimit.*

*Kerkojme gjithashtu verifikimin e plote te dokumentacionit te paraqitur te operatoreve te kualifikuar pasi ne mendojme se nuk i plotesojne kushtet e vendosura ne kriteret e veçanta ne DST per t'u kualifikuar.*

*Në datën 11.08.2018 prane zyrave tone ka ardhur shkresa Nr.330.Prot date 08.08.2018 me vendimin dt.07.08.2018 te Komisionit te shqyrtimit te Ankesave ku ka vendosur rrezimin e ankeses sone dhe vazhdimin e prcedures ispas fazave dhe afateve . (Bashkangjitur shkresa Nr.330.Prot date 08.08.2018)*

*Vendimi i KVO-se duke skualifikuar OE “ Vllaznia Ndertim I.S ” Sh.p.k eshte i padrejte kerkojme kualifikimin e ofertes tone .*

*Shoqeria “ Vllaznia Ndertim I.S ” Sh.p.k kërkon që të skualifikohen operatorët e ekonomik Selami Shpk pasi eshte kualifikuar në kundërshtim me Dokumentat Standarte te tenderti Shtojca 8 KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT , konkretisht pika : 2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera per te gjithe periudhen e percaktuar si afati i kryerj es se sherbimit. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa a te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.*

*Autoriteti Kontraktor nuk ka verifikuar deklaraten e OE Selami Shpk qe eshte fitues dhe ne dy Tendera me Drejtoria e Rajonit Verior Shkoder. Mendoj se e ka te veshtir Autoriteti Kontraktor verifikimin.[...]*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti

kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në autoritetin kontraktor dhe në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.1.2. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në autoritetin kontraktor dhe në KPP, ai të fitojë kontratën. Në rastin konkret, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k., ka ngritur pretendime në KPP, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Selami” sh.p.k. i cili është kualifikuar nga autoriteti kontraktor me ofertë më të ulët ekonomike se ajo e operatorit ekonomik ankimues. Sa më sipër, nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. rezulton se ky i fundit në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, ka ngritur pretendime vetëm mbi skualifikimin e ofertës së tij dhe nuk ka kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Selami” sh.p.k. edhe pse ky i fundit është kualifikuar dhe ka ofertuar me ofertë ekonomike më të ulët se operatori ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. Në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor ankimuesi ka kërkuar vetëm verifikim të dokumentacionit të operatorëve ekonomik të kualifikuar, pa identifikuar operatorin ekonomik të kualifikuar pa të drejtë nga autoriteti kontraktor, si dhe pa identifikuar shkeljen e kryer nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

III.1.3. Në kreun X “*Shqyrtimi i Ankesave*”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “*Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:* a) *Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjithësisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.*” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *[...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në*

*rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (*Neni 9 i K.pr. Administrative*). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik, Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar.

III.1.5. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar jo vetëm përpara Komisionit të Prokurimit Publik por edhe përpara autoritetit kontraktor, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë, si dhe të identifikojë operatorin ekonomik për të cilin ngre pretendimet e tij. Theksojmë se, mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/pretendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP dhe KSHA adaptojnë një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i KVO-së ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.1.7. Në këto kushte, konstatohet se operatori ekonomik ankimues "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k., në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk i ka parashtruar të gjitha arsyet për skualifikimin e operatorëve të tjerë nga kjo procedurë prokurimi, por ka ngritur pretendime në total, pa dhënë prova fakte dhe argumenta, e rrjedhimisht ankimi i paraqitur prej tij nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimimi në autoritetin kontraktor nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", e për pasojë nuk do të merren në shqyrtim.

III.1.8. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që operatori ekonomik "Selami" sh.p.k. do të vijojë të jetë i kualifikuar dhe me ofertë më të ulët ekonomike se operatori ekonomik ankimues, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar me ofertë më të ulët ekonomike.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga Ura e Cerencit - Steblevë, Qafë Bualli-Krastë, Burrel-Komesi; Ura e Matit-Lis; K/Ulëz-Ulëz; Trebisht-Dogane 75.92 km*”, me nr. REF-73550-06-05-2018, me fond limit 89,446,948 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.07.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1406 protokollit Datë 16.08.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**